3. **Eronita Jasiqi, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 9.61 dhe studimet master me notë mesatare 9.88. Kandidatja plotëson kushtet formale të përcaktuara në thirrje dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254. Komisioni vlerëson se kandidatja ka arritje të larta akademike dhe përgatitje të mirë profesionale në fushën përkatëse.

4. **Shyhrete Abazi Osmani, M.Sc.**, ka paraqitur aplikacion për pozitën e shpallur, mirëpo Komisioni konstatoi se dokumentacioni i dorëzuar nuk është i kompletuar sipas kërkesave të thirrjes publike. Gjithashtu, profili akademik i kandidates nuk është në përputhje me fushën për të cilën është shpallur kjo pozitë. Për rrjedhojë, kandidatja nuk i plotëson kushtet për t'u marrë në konsideratë për angazhim në këtë pozitë.

Pas shqyrtimit të përgjithshëm të dokumentacionit dhe vlerësimit të kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrje dhe në rregulloret në fuqi, Komisioni vlerësues propozon për angazhim si bashkëpunëtorë e jashtëm kandidaten **Kosovare Latifaj**.

Arsyetimi i propozimit bazohet në përmbushjen e kushteve të kërkuara për pozitën e shpallur, përshtatshmërinë e profilin akademik me lëndët e parapara në thirrje, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të dokumentacionit të paraqitur. Komisioni konsideron se kandidatja **Kosovare Latifaj** plotëson kriteret e nevojshme për të kontribuar në realizimin e procesit mësimor në lëndët përkatëse të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Prandaj, Komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe organeve kompetente të Universitetit të Prishtinës që kandidatja **Kosovare Latifaj** të angazhohet si bashkëpunëtorë e jashtëm për lëndët e shpallura në Pozitën Nr. 11.

1 Kryetar

Prof. Naser Sahiti

2 Anëtar

Prof. Rexhep Selimaj

3 Anëtar

Prof. Asoc. Bedri Dragusha

*M. Sahiti*  
*R. Selimaj*  
*B. Dragusha*



Nr. Prot: 1012

Datë: 24/06/2026

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (ad junct)**

Fakulteti:

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Pozita e shpallur në thirrje:

Pika VI, Pozita Nr. 12

Lëndët:

Furnizimi i ndërtesave me energji të ripërtëritshme (Z, BA),  
Termodinamika II (O, BA),  
Ekonomia energjetike (Z, BA),  
Sistemet e energjisë së biomasës (O, MA),  
Efiçienca e energjisë në pajisjet termike (Z, MA),  
Analiza e sistemeve energjetike (Z, MA),  
Socio-ekonomia në energjetikë (O, MA),  
Tubacionet (Z, BA),  
Termodinamika I (O, BA).

(shto radhë nëse duhet)

Kandidatët e paraqitur:

1. Rinor Muçaj
2. Kosovare Latifaj
3. Eronita Jasiqi

(shto radhë nëse duhet)

Thirrja për angazhim:

Nr. prot. 1/746, Dt. 29.05.2026

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar
4. Anëtar
5. Anëtar




Prof. Naser Sahiti

Prof. Rexhep Selimaj

Prof. Asoc. Bedri Dragusha

Prof.

Prof.



| Nr. | Emri dhe mbiemri | Grada shkencore | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata |  |  | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime |          |   |   | Moshë (datëlindja) | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet) | Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP. (PO/JO) | Propozohet të angazhohet (PO/JO) |
|-----|------------------|-----------------|---|--|--|--|----------|---|---|--------------------|---|---|----------------------------------|
|     |                  |                 | Thirrja akademike                                     | Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP | Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë) | Nota Ba.   | Nota Ma. | Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë/ përkatësisht certifikata profesionale për kontabilitet dhe |   |                    |   |   |                                  |
| 1.  | Rinor Muçaj      | Msc.            | -   | -  | -  | 8.58   | 9.69     | -   | - | 26                 | 0   | JO  |                                  |
| 2.  | Kosovare Latifaj | Msc             | -   | -  | -  | 9.26   | 9.44     | -   | - | 25                 | 0   | JO  |                                  |
| 3.  | Eronita Jasiqi   | Msc             | -   | -  | -  | 9.61   | 9.88     | -   | - | 25                 | 0   | PO  |                                  |

### RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlerësues, i emëruar nga Këshilli i FIM më 22.06.2026 për shqyrtimin e aplikacioneve për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm (ad junct) për lëndët e shpallura në Pozitën Nr. 12 të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve të paraqitur dhe vlerësimit sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren nr. 2/254, datë 17.07.2024, konstaton si në vijim:

1. **Rinor Muçaj, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 8.58 dhe studimet master me notë mesatare 9.69. Kandidati nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës. Dokumentacioni i dorëzuar dëshmon përgatitje të mirë akademike dhe përbushje të kushteve formale të përcaktuara në thirrje.

2. **Kosovare Latifaj, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 9.26 dhe studimet master me notë mesatare 9.44. Kandidatja plotëson kushtet formale të thirrjes dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254. Komisioni vlerëson se kandidatja posedon përgatitje të mirë akademike dhe potencial për angazhim në fushën përkatëse.

3. **Eronita Jasiqi, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 9.61 dhe studimet master me notë mesatare 9.88. Kandidatja plotëson kushtet formale të përcaktuara në thirrje dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254. Komisioni vlerëson se kandidatja ka arritje të larta akademike dhe përgatitje të mirë profesionale në fushën përkatëse.

Pas shqyrtimit të përgjithshëm të dokumentacionit dhe vlerësimit të kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrje dhe në rregulloret në fuqi, Komisioni vlerësues propozon për angazhim si bashkëpunëtorë e jashtëm kandidaten **Eronita Jasiqi**.

Arsyetimi i propozimit bazohet në përmbushjen e kushteve të kërkuara për pozitën e shpallur, përshtatshmërinë e profilit akademik me lëndët e parapara në thirrje, si dhe vlerësimin e përgjithshëm të dokumentacionit të paraqitur. Komisioni konsideron se kandidatja **Eronita Jasiqi** plotëson kriteret e nevojshme për të kontribuar në realizimin e procesit mësimor në lëndët përkatëse të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Prandaj, Komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit dhe organeve kompetente të Universitetit të Prishtinës që kandidatja **Eronita Jasiqi** të angazhohet si bashkëpunëtorë e jashtëm për lëndët e shpallura në Pozitën Nr. 12.

1 Kryetar

Prof. Naser Sahiti



2 Anëtar

Prof. Rexhep Selimaj



3 Anëtar

Prof. Asoc. Bedri Dragusha







Nr. Prot:

1034

Datë:

26 / 06 / 2026

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (ad junct)**

I Inxhinierisë Mekanike

Fakulteti:

Pozita 13.

Pozita e shpallur në thirrje:

Lëndët:

Një asistent për lëndet: Inxhinieri Industriale (O, BA), Organizimi i prodhimit (O, BA), Teknologjia e përpunimit të drurit (Z, BA), Përpunimi i materialeve polimere (Z, BA), Teoria e përpunimit me prerje (O, BA), Statistika Inxhinierike (Z, BA), Marketingu Industrial (Z, BA), Logjistika Teknike (Z, BA), Metrologjia në Prodhimtari (Z, BA).

*(shto radhë nëse duhet)*

Kandidatët e paraqitur:

1. Blerta Statovci
2. Arlinda Elezi
3. Arlind Tasholli

*(shto radhë nëse duhet)*

Nr. prot. 1/746, Dt. 29.05.2026

Thirrja për angazhim:

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Beqir Hamidi

Prof. Asoc. Afrim Gjellaj

Prof. Asoc. Fitore Abdullahu



| Nr. | Emri dhe mbiemri | Grada shkencore | Thirrja akademike |  | Applikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata                     |      | Applikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime |             | Moshë (datëlindja) | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet) | Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP. (PO/JO) | Propozohet të angazhohet (PO/JO) |
|-----|------------------|-----------------|-------------------|--|--|------|---|-------------|--------------------|---|---|----------------------------------|
|     |                  |                 | 1                 | 2  | 1  | 2    |   |             |                    |   |   |                                  |
| 1.  | Blerta Statovci  | MSc.            | 1                 | Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP | Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë) | 9.35 | Nota Ba.  | 28.04.20201 |                    | JO  |   |                                  |
| 2.  | Arlinda Elezi    | MSc.            |                   |  |  | 8.84 | Nota Ma.  | 16.05.20213 |                    | JO  |   |                                  |
| 3.  | Arlind Tasholli  | MSc.            |                   |  |  | 8.29 | Nota Ma.  | 13.02.1997  | 2 vite             | JO  | PO  |                                  |
| 4.  |                  |                 |                   |  |  |      |   |             |                    |   |   |                                  |

## RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

*(Ky raport duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohet/n për angazhim si bashkëpunëtor/ë i/të jashtëm).*

**Pasi që lëndët e paraqitura në konkurs i përkasin programit Prodhimtari dhe inxhinieri industriale, prandaj po i cekim të dhënat më poshtë:**

1. Kandidatja Blerta Statovci, i ka të përfunduara studimet ne Bachelor i ka në PIIM ndërsa Master Mekatronikë.
2. Kandidatja Arlidna Elezi, i ka të përfunduara dy nivelet e studimeve në PIIM.
3. Kandidati Arlind Tasholli, i ka të përfunduara dy nivelet e studimeve në PIIM dhe ka përvojë pune ne mësimdhënie ne FIM – UP.

**Kandidati Arlind Tasholli, i plotëson kushtet sipas rregullore andaj, propozohet për pozitën 13, pasi ka përvoje ne mësimdhënie në FIM-UP.**



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Nr. Prot: 1018  
Datë: 25/06/2026

### RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (*ad junct*)

|                                      |   |
|--------------------------------------|---|
| <b>Fakulteti:</b>                    | Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike / Departamenti i Mekatronikës   |
| <b>Pozita e shpallur në thirrje:</b> | Pozita 14 - Asistent i angazhuar për ushtrime   |
| <b>Lëndët:</b>                       | Dinamika e makinave (Z, BA), Communications Transmission (O, BA), Materialet mekanike dhe elektrike (O, BA), Bazat e mekatronikës (O, BA), Makinat për përpunim të ushqimit (Z, MA), Teknologjitë mekatronike në paketim të ushqimit (Z, MA), Menaxhimi në mekatronikë (O, BA). |
| <b>Kandidatët e paraqitur:</b>       | 1. Trëndelina Morina<br>2. Verona Gojnovci  |
| <b>Thirrja për angazhim:</b>         | Sipas thirrjes/vendimit nr. 1/746, datë 29.05.2026  |
| <b>Vendimi për komisionin:</b>       | Komisioni është emëruar me vendim të Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, mbledhja e datës 17.06.2026.   |
| <b>Komisioni vlerësues:</b>          | 1. Kryetar - Prof. Dr. Ramë Likaj<br>2. Anëtar - Prof. Dr. Ahmet Shala<br>3. Anëtar – Prof.Asst. Dr. Ilir Murturi   |
| <b>Qëllimi i raportit:</b>           | Shqyrtimi i dokumentacionit të kandidatëve dhe propozimi për angazhim si bashkëpunëtor i jashtëm/asistent i angazhuar për ushtrime për pozitën përkatëse.   |

**TABELA VLERËSUERE E KANDIDATËVE**

| Nr. | Emri dhe mbiemri  | Kualifikimi / grada  | Apl. për ligjërata / thirrja akademike | Publikimet  | Nota BA | Nota MA | Mosha / datëlindja | Përvoja në fushën përkatëse  | Bie ndesh me Rreg. nr. 2/254 (PO/JO) | Renditja | Propozohet (PO/JO) |
|-----|-------------------|--|--|---|---------|---------|--------------------|--|--------------------------------------|----------|--------------------|
| 1.  | Trëndelina Morina | MSc në Inxhinieri Mekanike – Mekatronikë, BSc në Inxhinieri Mekanike - Mekatronikë                           | Jo / nuk aplikohet                     | Nuk janë dorëzuar dëshmi të veçanta për publikime shkencore/profesionale.   | 8.75    | 9.88    | 06.01.2003         | Përvojë praktike/profesionale: Agjencia e Metrologjisë e Kosovës; Ferplast; Bora Dental SH.P.K. (instalim, servis, mirëmbajtje, diagnostikim dhe verifikim i pajisjeve). | JO                                   | 1        | PO                 |
| 2.  | Verona Gojnovci   | MSc në Inxhinieri Mekanike – Mekatronikë, BSc në Inxhinieri Mekanike - Inxhinieri Industriale dhe Menaxhment | Jo / nuk aplikohet                     | Ka dorëzuar punim shkencor/profesional: "Regulation of the liquid inflow level through a closed-loop system"; dëshmi për Distinguished Paper Award, ICISE 2026. | 8.45    | 9.06    | 02.03.2000         | Përvojë profesionale/praktike: Design engineer në Netxio, Assistant manager në Auto Passion: praktikë/përvojë në ORCA dhe KEK: AutoCAD/SolidWorks/MathCAD.               | JO                                   | 2        | JO                 |

## RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlerësues shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur për pozita 14 - asistent i angazhuar për ushtrime në Departamentin e Mekatronikës. Në këtë pozitë kanë aplikuar Trëndelina Morina dhe Verona Gojnovci. Vlerësimi është bërë në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, përputhjes së kualifikimit me lëndët e pozitës, notave mesatare, përvojës profesionale/praktike dhe dëshmime të tjera relevante.

Trëndelina Morina ka përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Mekanike - Mekatronikë me notë mesatare 8.75 dhe studimet Master në Mekatronikë me notë mesatare 9.88, 120 ECTS, niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Dokumenti i diplomës së masterit dëshmon se tema e mbrojtur lidhet me krahasimin e rregullatorëve PID dhe LQR dhe optimizimin me algoritëm gjenetik në sistem aktiv të varjes. Kandidatja ka përvojë praktike/profesionale në metrologji, në industri dhe në servis/diagnostikim të pajisjeve.

Verona Gojnovci ka përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Mekanike - Inxhinieri Industriale dhe Menaxhment me notë mesatare 8.45 dhe studimet Master në Mekatronikë me notë mesatare 9.06, 120 ECTS, niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Kandidatja ka dorëzuar dëshmi për punim shkencor/profesional në kontroll të nivelit të lëngut në sistem të mbyllur dhe dëshmi për Distinguished Paper Award, ICISE 2026, si dhe ka përvojë profesionale në projektim dhe CAD.




### Përfundimi

Për pozitën 14, Komisioni vlerëson se kandidatja **Trëndelina Morina** ka përputhje më të drejtpërdrejtë me grupin e lëndëve të Mekatronikës, bazave të mekatronikës, materialeve dhe teknologjive mekatronike, duke marrë parasysh profilin Bachelor dhe Master në Mekatronikë, notën mesatare më të lartë në studimet Master (9.88), temën e masterit në kontroll dhe optimizim të sistemeve dinamike, si dhe përvojën praktike në matje, diagnostikim dhe mirëmbajtje të pajisjeve. Kandidatja Verona Gojnovci ka kualifikim të përshtatshëm dhe dëshmi të mirë shkencore/profesionale, por për këtë pozitë renditet e dyta për shkak të notës mesatare më të ulët në BA/MA dhe përputhjes më pak të drejtpërdrejtë të studimeve bazë me lëndët e kësaj pozite.

**Në përfundim, Komisioni vlerësues propozon që për pozitën 14 të angazhohet kandidatja Trëndelina Morina. Kandidatja tjetër e shqyrtuar Verona Gojnovci vlerësohet si e kualifikuar dhe e përshtatshme në aspektin e përgjithshëm, mirëpo, bazuar në krahasimin e dokumentacionit, përputhjen me kërkesat e pozitës dhe arsyetimin e paraqitur më lart, renditet e dyta dhe konsiderohet si kandidate rezervë për këtë pozitë.**

*Vërejtje teknike: Te kandidatja Verona Gojnovci ekziston mospërputhje e datës së lindjes në kërkesën për aplikim (02.02.2000) krahasuar me ekstraktin/diplomat (02.03.2000). Në këtë raport është përdorur data zyrtare nga ekstrakti/diplomat: 02.03.2000.*

### NËNSHKRIMET E KOMISIONIT VLERËSUES

| Roli    | Emri dhe mbiemri           | Nënshkrimi  |
|---------|----------------------------|---|
| Kryetar | Prof. Dr. Ramë Likaj       |  |
| Anëtar  | Prof. Dr. Ahmet Shala      |  |
| Anëtar  | Prof.Asst.Dr. Ilir Murturi |  |



# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Nr. Prot: 1017  
Datë: 25/06/2026

## RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (*ad junct*)

|                                      |   |
|--------------------------------------|---|
| <b>Fakulteti:</b>                    | Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike / Departamenti i Mekatronikës   |
| <b>Pozita e shpallur në thirrje:</b> | Pozita 15 - Asistent i angazhuar për ushtrime   |
| <b>Lëndët:</b>                       | Dinamika jolineare e sistemeve mekanike (O, MA), Metoda e elementëve të fundme (Z, MA), Diagnostikimi i sistemeve mekatronike në automjete (Z, MA), Sistemet e kohës reale dhe hardueri (O, MA), Inxhinieringu softuerik (Z, MA), Hyrje në softuerët inxhinierikë (Z, BA), Rregullimi inxhinierik i pajisjeve dhe robotët industrialë (O, BA), Bazat e automatizimit (Z, BA). |
| <b>Kandidatët e paraqitur:</b>       | 1. Trëndelina Morina<br>2. Verona Gojnovci  |
| <b>Thirrja për angazhim:</b>         | Sipas thirrjes/vendimit nr. 1/746, datë 29.05.2026  |
| <b>Vendimi për komisionin:</b>       | Komisioni është emëruar me vendim të Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, mbledhja e datës 17.06.2026.   |
| <b>Komisioni vlerësues:</b>          | 1. Kryetar - Prof. Dr. Ramë Likaj<br>2. Anëtar - Prof. Dr. Ahmet Shala<br>3. Anëtar – Prof.Asst. Dr. Ilir Murturi   |
| <b>Qëllimi i raportit:</b>           | Shqyrtimi i dokumentacionit të kandidatëve dhe propozimi për angazhim si bashkëpunëtor i jashtëm/asistent i angazhuar për ushtrime për pozitën përkatëse.   |

**TABELA VLERËSUESE E KANDIDATËVE**

| Nr. | Emri dhe mbiemri  | Kualifikimi / grada  | Apl. për ligjërata / thirrja akademike | Publikimet  | Nota BA | Nota MA | Mosha / datëlindja | Përvoja në fushën përkatëse  | Bie ndesh me Rreg. nr. 2/254 (PO/JO) | Renditja | Propozohet (PO/JO) |
|-----|-------------------|--|--|---|---------|---------|--------------------|--|--------------------------------------|----------|--------------------|
| 1.  | Trëndelina Morina | MSc në Inxhinieri Mekanike - Mekatronikë; BSc në Inxhinieri Mekanike - Mekatronikë                           | Jo / nuk aplikohet                     | Nuk janë dorëzuar dëshmi të veçanta për publikime shkencore/profesionale.   | 8.75    | 9.88    | 06.01.2003         | Përvojë praktike/profesionale: Agjencia e Metrologjisë e Kosovës; Ferplast; Bora Dental SH.P.K. (instalim, servis, mirëmbajtje, diagnostikim dhe verifikim i pajisjeve). | JO                                   | 1        | PO                 |
| 2.  | Verona Gojnovci   | MSc në Inxhinieri Mekanike - Mekatronikë; BSc në Inxhinieri Mekanike - Inxhinieri Industriale dhe Menaxhment | Jo / nuk aplikohet                     | Ka dorëzuar punim shkencor/profesional: "Regulation of the liquid inflow level through a closed-loop system"; dëshmi për Distinguished Paper Award, ICISE 2026. | 8.45    | 9.06    | 02.03.2000         | Përvojë profesionale/praktike: Design engineer në Nettixio; Assistant manager në Auto Passion; praktikë/përvojë në ORCA dhe KEK.   | JO                                   | 2        | JO                 |

## RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlerësues shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur për pozita 15 - asistent i angazhuar për ushtrime në Departamentin e Mekatronikës. Në këtë pozitë kanë aplikuar Trëndelina Morina dhe Verona Gojnovci. Vlerësimi është bërë në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, përputhjes së kualifikimit me lëndët e pozitës, notave mesatare, përvojës profesionale/praktike dhe dëshmime të tjera relevante.

Trëndelina Morina ka përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Mekanike - Mekatronikë me notë mesatare 8.75 dhe studimet Master në Mekatronikë me notë mesatare 9.88, 120 ECTS, niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Dokumenti i diplomës së masterit dëshmon se tema e mbrojtur lidhet me krahasimin e rregullatorëve PID dhe LQR dhe optimizimin me algoritëm gjenetik në sistem aktiv të varjes. Kandidatja ka përvojë praktike/profesionale në metrologji, në industri dhe në servis/diagnostikim të pajisjeve.

Verona Gojnovci ka përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Mekanike - Inxhinieri Industriale dhe Menaxhment me notë mesatare 8.45 dhe studimet Master në Mekatronikë me notë mesatare 9.06, 120 ECTS, niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Kandidatja ka dorëzuar dëshmi për punim shkencor/profesional në kontroll të nivelit të lëngut në sistem të mbyllur dhe dëshmi për Distinguished Paper Award, ICISE 2026, si dhe ka përvojë profesionale në projektim dhe CAD.




### Përfundimi

Për pozitën 15, Komisioni vlerëson se kandidatja Trëndelina Morina ka përputhje shumë të mirë me lëndët e avancuara të dinamikës, automatizimit, rregullimit inxhinierik, diagnostikimit dhe softuerëve inxhinierikë. Tema e saj e masterit, e orientuar në krahasimin e rregullatorëve PID dhe LQR dhe optimizimin me algoritëm gjenetik në sistem aktiv të varjes, lidhet drejtpërdrejt me dinamikën e sistemeve, kontrollin dhe simulimin. Po ashtu, dëshmitë për përdorimin e MATLAB/Simulink, Python, C++, SolidWorks, AutoCAD dhe Abaqus janë relevante për këtë pozitë. Kandidatja

Verona Gojnovci ka publikim/projekt të vlefshëm në kontroll të nivelit të lëngut dhe përvojë profesionale, por në krahasim me Trëndelina Morinën ka notë mesatare më të ulët në studimet Master dhe më pak dëshmi të drejtpërdrejta për temat si metoda e elementëve të fundme dhe optimizimi i sistemeve dinamike. **Në përfundim, Komisioni vlerësues propozon që për pozitën 14 të angazhohet kandidatja Trëndelina Morina. Kandidatja tjetër e shqyrtuar Verona Gojnovci vlerësohet si e kualifikuar dhe e përshtatshme në aspektin e përgjithshëm, mirëpo, bazuar në krahasimin e dokumentacionit, përputhjen me kërkesat e pozitës dhe arsyetimin e paraqitur më lart, renditet e dyta dhe konsiderohet si kandidate rezervë për këtë pozitë.**

*Vërejtje teknike: Te kandidatja Verona Gojnovci ekziston mospërputhje e datës së lindjes në kërkesën për aplikim (02.02.2000) krahasuar me ekstraktin/diplomat (02.03.2000). Në këtë raport është përdorur data zyrtare nga ekstrakti/diplomat: 02.03.2000.*

### NËNSHKRIMET E KOMISIONIT VLERËSUES

| Roli    | Emri dhe mbiemri           | Nënshkrimi  |
|---------|----------------------------|---|
| Kryetar | Prof. Dr. Ramë Likaj       |  |
| Anëtar  | Prof. Dr. Ahmet Shala      |  |
| Anëtar  | Prof.Asst.Dr. Ilir Murturi |  |



Nr. Prot: 1026  
Datë: 26 / 06 / 2026

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (ad junct)**

Fakulteti: Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike  
Pozita e shpallur në thirrje: VI.16  
Lëndët: Vizatim me kompjuter (O, BA)  
Grafika inxhinierike (O, BA)  
Kandidatët e paraqitur: Arben Mujaj  
Arlinda Elezi  
Rinor Muçaj  
Thirrja për angazhim: Nr. prot. 1/746, Dt. 29.05.2026

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar Prof. Beqir Hamidi
2. Anëtar Prof. Nase Lajqi
3. Anëtar Prof. Asst. Halil Demolli

|                 |  |   |  |
|-----------------|--|---|--|
| 1.              | Nr.  |   |  |
|                 | Emri dhe mbiemri   | Arben Mujaj   |  |
| Msc             | Grada shkencore  |   |  |
| .               | Thirrja akademike  | Aplikohet për bashkëpunësorët e jashtëm për ligjërata   |  |
| .               | Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunësorëve të jashtëm në UP |   |  |
| .               | Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)   |   |  |
| 8.38            | Nota Ba.   | Aplikohet për bashkëpunësorët e jashtëm për ushtrime  |  |
| 9.06            | Nota Ma.   |   |  |
|                 | Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë/ përkatësisht certifikata profesionale për kontabilitet dhe auditim  |   |  |
| 29 (19.09.1997) |  | Mosha (datëlindja)  |  |
| 0               |  | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet)   |  |
| JO              |  | Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunësorëve të jashtëm në UP. (PO/JO) |  |
| JO              |  | Propozohet të angazhohet (PO/JO)  |  |

|    |               |     |   |   |   |      |      |  |                 |   |    |    |
|----|---------------|-----|---|---|---|------|------|--|-----------------|---|----|----|
| 2. | Arlinda Elezi | Msc | - | - | - | 8.84 | 9.69 |  | 27 (10.05.1999) | 0 | JO | PO |
| 3. | Rinor Muçaj   | Msc | - | - | - | 8.58 | 9.69 |  | 26 (30.01.2000) | 0 | JO | JO |

### RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlerësues, i emëruar nga Këshilli i FIM më 22.06.2026 për shqyrtimin e aplikacioneve për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm (ad junct) për lëndët e shpallura në Pozitën Nr. 16 të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve të paraqitur dhe vlerësimit sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren nr. 2/254, datë 17.07.2024, konstaton si në vijim:

1 **Arben Mujaj, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 8.36 dhe studimet master me notë mesatare 9.06. Kandidati plotëson kushtet formale të thirrjes dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254.

2. **Arlinda Elezi, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 8.84 dhe studimet master me notë mesatare 9.69. Kandidatja plotëson kushtet formale të thirrjes dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254.

3. **Rinor Muçaj, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 8.58 dhe studimet master me notë mesatare 9.69. Kandidati plotëson kushtet formale të përcaktuara në thirrje dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254.

Pas shqyrtimit të përgjithshëm të dokumentacionit dhe vlerësimit të kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrje dhe në rregulloret në fuqi, Komisioni vlerësues propozon për angazhim si bashkëpunëtor i jashtëm kandidaten **Arlinda Elezi**. Arsyetimi i propozimit bazohet në përmbushjen e kushteve të kërkuara për pozitën e shpallur dhe notën mesatare të studimeve. Prandaj, Komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe organeve kompetente të Universitetit të Prishtinës që kandidatja **Arlinda Elezi** të angazhohet si bashkëpunëtor i jashtëm për lëndët e shpallura në Pozitën Nr. 16.

Prishtinë,

Më 26.06.2026

Komisioni:

Prof. Beqir Hamidi, Kryetar 

Prof. Naser Lajqi, Anëtar 

Prof. Asst. Halil Demolli, Anëtar 



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Nr. Prot: 1020  
Datë: 25/06/2026

### RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (*ad junct*)

|                                |  |
|--------------------------------|--|
| <b>Fakulteti:</b>              | Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike  |
| <b>Pozita:</b>                 | Pozita 17 - Asistent i angazhuar për ushtrime  |
| <b>Lëndët:</b>                 | Softuerët aplikativë (O, BA), Informatika dhe programimi (O, BA)   |
| <b>Kandidatët e shqyrtuar:</b> | 1. Erzë Ahmeti,<br>2. Erëza Abdullahu,<br>3. Rinor Muçaj,<br>4. Arben Mujaj  |
| <b>Thirrja për angazhim:</b>   | Sipas thirrjes/vendimit nr. 1/746, datë 29.05.2026   |
| <b>Komisioni vlerësues:</b>    | 1. Kryetar - Prof. Dr. Ramë Likaj,<br>2. Anëtar - Prof. Dr. Ahmet Shala,<br>3. Anëtar – Prof.Asst.Dr. Ilir Murturi |

#### 1. Qëllimi, kriteret e vlerësimit dhe baza rregullative

Komisioni shqyrtoi dokumentacionin e katër kandidatëve për pozitën 17 dhe bëri krahasimin mbi bazën e përputhjes me lëndët Softuerët aplikativë dhe Informatika dhe programimi, duke marrë parasysh kreditë, notat, fushën e studimeve, përvojën, publikimet, referencat, dokumentacionin formal dhe përmbajtjen konkrete të të dy syllabus-eve.

Vlerësimi është harmonizuar me Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, të miratuar nga Senati i UP-së më 12.07.2024, nr. prot. 2/259, si dhe me thirrjen publike për angazhim.

Sipas nenit 7 të kësaj Rregulloreje, për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime kandidati duhet të ketë të përfunduara studimet master ose ekuivalente me të në fushën përkatëse dhe notë mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit. I njëjti nen parasheh se, kur më shumë se një

kandidat i plotëson kriteret, përparësia e kandidatit të caktuar mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues, duke u bazuar në arsyetimin profesional dhe dokumentacionin e dorëzuar.

Shënim për kreditë dhe ekuivalentimin: Vendimet e MASHTI/NARIC njohin gradën, nivelin dhe kreditë, por jo gjithmonë japin notë të konvertuar numerike. Për krahasim orientues, notat janë paraqitur në shkallën origjinale dhe, kur ka qenë e nevojshme, është dhënë interpretim i kujdesshëm në shkallën 6-10. Për kandidaturat me studime jashtë vendit, komisioni nuk bën nostrifikim të ri, por mbështetet në vendimet/dëshmitë zyrtare të dorëzuara.

**Kandidatët Rinor Muçaj dhe Arben Mujaj janë përfshirë në raport sipas listës së kandidatëve të dhënë për shqyrtim nga komisioni, dokumentacioni i tyre kryesor lidhet me fusha të tjera të FIM-it, prandaj përputhja me pozitën 17 është vlerësuar në raport me përmbajtjen konkrete të lëndëve të shpallura.**

## 2. Analiza e lëndëve të konkursit 17 dhe kompetencave të kërkuara

Pozita 17 përfshin dy lëndë obligative BA: Softuerët aplikativë dhe Informatika dhe programimi. Meqenëse pozita është për ushtrime, vlerësimi u përqendrua në aftësinë për të udhëhequr punë laboratorike, detyra praktike, ushtrime softuerike, shembuj të programimit, materiale mësimore dhe vlerësim të studentëve.

Sipas syllabus-eve, lënda Softuerët aplikativë zhvillohet në semestrin II, 2+2 orë, 5.5 ECTS, me raport 30% teori/70% praktikë dhe fokusohet në Maple, IQ100 dhe Working Model 2D për llogaritje matematikore/simbolike, probleme të Statikës dhe Rezistencës së Materialeve, trarë, kapriata dhe simulim mekanizmash. Lënda Informatika dhe programimi zhvillohet në semestrin I, 2+2 orë, 6 ECTS, me raport 30% teori/70% praktikë dhe fokusohet në OS, MS Office, Excel/grafikë/makro, MathCad dhe bazat e C++.

| Lënda                              | Fokusi kryesor në nivel BA   | Kompetencat e kërkuara për asistentin e ushtrimeve   |
|------------------------------------|--|--|
| Softuerët aplikativë (O, BA)       | Maple për llogaritje matematikore/simbolike, IQ100 për Statikë dhe Rezistencë të Materialeve: Working Model 2D për mekanizma bazikë dhe simulim. Lënda është praktike/laboratorike me fokus inxhinierik mekanik.                   | Demonstrim laboratorik i softuerëve inxhinierikë; përgatitje detyrash nga statika, trarët, kapriatat, rezistenca e materialeve dhe mekanizmat, interpretim të rezultateve numerike/grafike dhe lidhje me problemet mekanike. |
| Informatika dhe programimi (O, BA) | Bazat e punës me kompjuter: OS, MS Office, Word, Excel për llogaritje/grafikë/makro, PowerPoint: MathCad për numra kompleksë, sisteme ekuacionesh, vektorë, matrica dhe grafikë: bazat e C++ dhe përdorimi i editorëve/kompilimit. | Udhëheqje ushtrimesh në OS/Office/Excel, MathCad dhe C++: shpjegim i koncepteve bazike të programimit, variabla, konstantave, strukturës së kodit, kompilimit dhe zgjidhjes së problemeve matematikore me kod.               |

Nga kjo analizë rezulton se kandidati/ja më i/e përshtatshëm/e duhet të ketë dy shtylla: formim të qëndrueshëm në informatikë/programim dhe aftësi për t'u përshtatur me softuerë aplikativë inxhinierikë. Meqenëse asnjëri kandidat nuk dëshmon drejtpërdrejt Maple, IQ100, Working Model 2D ose

MathCad, komisioni vlerësoi dëshmitë më të afërta: programim, sisteme softuerike, përpunim të dhënash, softuerë teknikë, përvojë pedagogjike dhe aftësi laboratorike.

Në këtë kuadër, Erëza Ahmeti ka përparësinë më të theksuar formale, pedagogjike dhe praktike për lëndën Informatikë dhe programim. Vendimi i MASHTI/NARIC nr. 11/3-2061, datë 29.08.2025, i njej gradën "Master i Shkencave në Teknologjinë e Informacionit me Menaxhim", të përfunduar me rezultate të shkëlqyera, "Distinction", në University of St Andrews. Programi është njëvjeçar, me 90 ECTS dhe i përket nivelit 7 sipas KKK/KEK.

Studimet Bachelor në RIT Kosovo përbëjnë një program katërvjeçar amerikan Bachelor of Science, me 123 kredite amerikane dhe GPA 3.95/4.0.

Erëza Abdullahu ka portofol të mirë shkencor për lëndën Informatikë dhe programim, për shkak të formimit në Shkenca Kompjuterike, masterit me diplomë të dyfishtë dhe publikimeve në fushën e inteligjencës artificiale dhe softuerit.

Sa i përket nostrifikimit, vendimi i MASHTI/NARIC nr. 216-4869, datë 27.10.2021, i njej Erëza Abdullahut gradën "E diplomuar në Shkenca Kompjuterike", të fituar pas studimeve trevjeçare me 180 ECTS në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut. Në nivelin master, dokumentacioni akademik dhe CV-ja e paraqesin kualifikimin si master me diplomë të dyfishtë UNICAM–FHNW.

3. Tabela krahasuese e dokumentacionit, kredive dhe notave

| Nr | Kandidati   | Aplikimi për poz. 17  | BSc - kredite/nota   | MSc - kredite/nota   | Mosha / datëlindja | Njohja / ekuivalentimi  | Përputhja me lëndët   | Renditja |
|----|-------------|---|--|--|--------------------|---|---|----------|
| 1  | Erzë Ahmeti | Po - Softuerët aplikativë; Informatika dhe programimi. Ka aplikuar edhe për pozitën 20. | BSc Applied Arts and Sciences, RIT Kosovo, Web/Mobile Computing & Management, program 4-vjeçar amerikan, 123 US credits; GPA 3.95/4.0, summa cum laude. Nuk shënohet si 180 ECTS, por si program Bachelor amerikan, si krahasim orientues i ngarkesës akademike, 123 US credits, (240-246 ECTS) workload equivalent. | MSc Information Technology with Management, University of St Andrews, with Distinction, MASHTI/NARIC: 90 ECTS, niveli 7. | 01.08.2000         | MASHTI/NARIC 11/3-2061, 29.08.2025: MSc IT with Management, 90 ECTS, niveli 7. Trajtohet si master/equivalent në fushë përkatëse. | Shumë e mirë në aspektin praktik dhe pedagogjik për lëndën Informatikë dhe programim. | 1        |

|   |                  |  |  |  |            |   |  |   |
|---|------------------|--|--|--|------------|---|--|---|
| 2 | Erëza Abdullah u | Po - Softuerët aplikativë; Informatika dhe programimi  | BSc Shkenca Kompjuterike, SEEU, 180 ECTS, nota 9.62/10               | Një master/diplomë e dyfishtë: UNICAM MSc Computer Science - AI & Informatics for Robotics, 110/110; FHNW MSc Business Information Systems, 5.4/6. | 06.06.2000 | BSc: MASHTI/NARIC 216-4869, 27.10.2021, 180 ECTS. Masteri evidentohet si kualifikim double degree UNICAM-FHNW, jo si dy masterë të ndarë. | Shumë e mirë për lëndën Informatikë dhe programim.   | 2 |
| 3 | Rinor Muçaj      | I përfshirë në vlerësim sipas listës së kandidatëve; në dosje u gjetën aplikime për pozita/fusha të tjera.   | BSc Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtërishme, FIM/UP, nota 8.58. | MSc Sistemet e Energjisë së Ripërtërishme, FIM/UP, nota 9.69.  | 30.01.2000 | Studime vendore në UP; nuk kërkohet nostrifikim. I plotëson kriteret e notës, por fusha nuk është drejtpërdrejt relevante për pozitën 17. | E pjesshme për SA për shkak të bazës inxhinierike: e kufizuar për Informatika dhe programimi, pa dëshmi për C++/MathCad ose softuerët specifikë të SA. | 3 |
| 4 | Arben Mujaj      | I përfshirë në vlerësim sipas listës së kandidatëve; dokumentacioni kryesor lidhet me komunikacion/transport | BSc Komunikacion dhe Transport, FIM/UP, nota e evidentuar 8.38.      | MSc Komunikacion Rrugor, FIM/UP; nota e evidentuar 9.06.   | 19.09.1997 | Studime vendore në UP; nuk kërkohet nostrifikim. I plotëson kriteret e notës, por fusha nuk është drejtpërdrejt relevante për pozitën 17. | E ulët për Informatika dhe programimi: e kufizuar për SA. Ka MS Office/AutoCAD/PC-CRASH, por jo C++/MathCad dhe jo Maple/IQ100/Working Model 2D.       | 4 |

#### 4. Vlerësimi individual i kandidatëve

##### 4.1. Erzë Ahmeti

Kandidatja ka aplikuar drejtpërdrejt për pozitën 17 dhe ka profil shumë të mirë praktik në TI, programim, web/mobile computing, UI/UX, AI dhe mësimdhënie/trajnim. Në BSc ka përfunduar studimet në RIT Kosovo në sistemin amerikan me fokus në Web/Mobile Computing dhe Management & Entrepreneurship, me sukses shumë të lartë; në MSc ka përfunduar Information Technology with Management në University of St Andrews me Distinction.

Erzë Ahmerti ka përfunduar studimet në RIT që është program Bachelor 4-vjeçar amerikan dhe në krahasim orientues të ngarkesës akademike, 123 US credits korrespondojnë afërsisht 240 - 246 ECTS workload equivalent. Prandaj ky kualifikim është më i lartë se Bachelor-i 180 ECTS i sistemit të Bolonjës. Por ne si komision e kemi bërë përshkrimin në sistemin origjinal amerikan dhe nuk bëjmë konvertim zyrtar jashtë dokumentacionit të paraqitur.

Masteri i saj është njohur nga MASHTI/NARIC si Master i Shkencave në Teknologjinë e Informacionit me Menaxhim, me 90 ECTS, niveli 7. Duke qenë se Rregullorja e UP-së për pozitën e ushtrimeve kërkon studime master ose ekuivalente në fushën përkatëse dhe notë mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet.

Për Informatikë dhe programim, përvoja e saj është shumë relevante në aspektin pedagogjik: mësimdhënie e informatikës, bazat e programimit, JavaScript, Java dhe AI: trajnime në Python dhe front-end development.

**Kandidaturë shumë e mirë dhe më e përshtatshme sa i përket përvojës praktike, aftësive pedagogjike dhe referencave profesionale. Profili i kandidatit përputhet shumë mirë me lëndën "Informatika dhe Programimi", veçanërisht për realizimin e mësimin praktik.**

##### 4.2. Erëza Abdullahu

Kandidatja ka aplikuar drejtpërdrejt për pozitën 17 dhe ka formim në Shkenca Kompjuterike: BSc i njohur nga MASHTI/NARIC si studime 3-vjeçare, 180 ECTS, nota 9.62, dhe master në Shkenca Kompjuterike - Artificial Intelligence and Informatics for Robotics në University of Camerino, si program me diplomë të dyfishtë me FHNW - Business Information Systems. Kualifikimi duhet të trajtohet si master me diplomë të dyfishtë, jo si dy masterë të ndarë, me rezultate 110/110 në UNICAM dhe 5.4/6 në FHNW.

Për Informatikë dhe programim, profili i saj është shumë i mirë për shkak të formimit në CS, programim, DBMS, SQL, machine learning dhe zhvillim softuerik.

Kandidatja ka dorëzuar një vërtetim nga Universiteti i Camerino-s që dëshmon se ka qenë përfituese e një burse hulumtuese nga 15.12.2025 deri më 15.06.2026. Dokumenti dëshmon angazhim hulumtues, por jo përvojë në mësimdhënie në arsimin e lartë.

**Kandidaturë shumë e mirë nga aspekti praktik, me përputhje të mirë me lëndën "Informatikë dhe Programim".**

##### 4.3. Rinor Muçaj

Kandidati ka formim të mirë akademik në FIM/UP: BSc në Termoenergjetikë dhe Energji të Ripërtërishme me notë 8.58 dhe MSc në Sistemet e Energjisë së Ripërtërishme me notë 9.69. Ka përvojë si inxhinier projektues i sistemeve HVAC, udhëheqës në punishte dhe menaxhim projektesh.

Për pozitën 17, përputhja është e kufizuar për Informatika dhe programimi, sepse profili kryesor është energjetik/termoenergjetik, jo CS/programim. Për Softuerët aplikativë ka afërsi të pjesshme inxhinierike, për shkak të bazës mekanike dhe përvojës me projektim/sisteme teknike, por nuk ka dëshmi për Maple, IQ100, Working Model 2D ose MathCad.

Kandidat i mirë në fushën e energjetikës dhe me afërsi të pjesshme për komponentin inxhinierik të SA, por jo ndër kandidatët më të përshtatshëm për pozitën 17 për shkak të mungesës së profilit të drejtpërdrejtë në informatikë/programim dhe softuerët specifikë të syllabus-eve.

#### **4.4. Arben Mujaj**

Kandidati ka formim në Komunikacion dhe Transport/Komunikacion Rrugor dhe përvojë si ligjërues profesional në autoshkollë, instruktor, praktikant në komunë dhe në ekspertiza të aksidenteve. Ka njohuri në Microsoft Office, AutoCAD, PC-CRASH dhe softuerë/simulime të komunikacionit.

Për pozitën 17, përputhja është më e ulët, sepse fusha kryesore është komunikacioni/transporti, jo CS/programim. Njohuritë në Microsoft Office, AutoCAD, PC-CRASH dhe softuerë të komunikacionit krijojnë vetëm afërsi të kufizuar me softuerët aplikativë, por jo me Maple, IQ100, Working Model 2D, MathCad ose C++ sipas syllabus-eve.

Kandidat me përvojë praktike dhe ligjëruese në fushë tjetër, por pa përputhje të mjaftueshme me pozitën 17, veçanërisht me Informatika dhe programimi dhe me softuerët specifikë të SA.

5. Tabela përmbledhëse e vlerësimit përfundimtar

| Renditja | Kandidati       | Përputhja me lëndët  | Kreditet BA/MA  | Nota / sukcesi  | Përvoja relevante  | Publikime / referenca  | Propozimi               |
|----------|-----------------|--|---|---|--|--|-------------------------|
| 1        | Erzë Ahmeti     | Shumë e mirë praktike/pedagogjike për programim bazik: e pjesshme/e mirë për SA, jo drejtpërdrejt për MathCad dhe Maple/IQ100/Working Model 2D | BA RIT Kosovo, program 4-vjeçar amerikan, 123 US credits (240- 246 ECTS workload equivalent, krahasim orientues; jo konvertim zyrtar) MA 90 ECTS sipas MASHTI/NARIC, 11/3-2061, datë 29.08.2025 | BA 3.95/4; MA GPA 16.6/20.0 Distinction, St.Andrews, MB | Mësimdhënëse informatike, ligjëruese universitare, vlerësim 92%, trajnere Python/front-end, web developer, UI/UX, AI/Product | Punim/projekt RIT për Skills Gap in IT Sector in Kosovo, 2 prezantime në konferenca; 5 dëshmi/referenca dhe vlerësim studentor 92% | Propozohet për angazhim |
| 2        | Erëza Abdullahu | Shumë e lartë për Informatika dhe programimi: e mirë/e arsyeshme për SA, por pa dëshmi specifike për Maple/IQ100/Working Model 2D/MathCad      | BA 180 ECTS, UEJL, Maqedoni e Veriut, nostrifikimi 216-4869, datë 27.10.2021. MA 120 ECTS me diplomë të dyfishtë UNICAM-FHNW  | BA 9.62; MA 110/110; komponenti FHNW 5.4/6              | AI trainer, Research Fellow, ASSECO, AI/ML/CV: përvojë softuerike dhe trajnuese, jo specifike për softuerët e syllabus-eve   | 3 punime shkencore shumë relevante: Sensors/IoT-face recognition, IEEE BIBM/CNN, AINA 2026/AI movement evaluation                  | Rezervë e parë          |
| 3        | Rinor Muçaj     | E pjesshme për SA në aspektin inxhinierik: e kufizuar për Informatika dhe programimi   | BA/MA FIM-UP  | BA 8.58; MA 9.69  | HVAC, projektim, menaxhim projektesh; afërsi inxhinierike, por jo programim/MathCad apo softuerët specifike të SA            | Nuk janë thelbësore për pozitën 17   | Nuk propozohet          |

|   |             |   |              |                  |  |                                    |                |
|---|-------------|---|--------------|------------------|--|------------------------------------|----------------|
| 4 | Arben Mujaj | E kufizuar për SA dhe e ulët për Informatika dhe programimi | BA/MA FIM-UP | BA 8.38; MA 9.06 | Ligjërues/instruktor në komunikacion; MS Office, AutoCAD/PC-CRASH dhe softuerë komunikacioni | Nuk janë thelbësore për pozitën 17 | Nuk propozohet |
|---|-------------|---|--------------|------------------|--|------------------------------------|----------------|

## 6. Përfundimi dhe propozimi i Komisionit

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, krahasimit të katër kandidatëve, analizës së detajuar të syllabus-eve të lëndëve të pozitës 17 dhe harmonizimit të vlerësimit me Rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, Komisioni vlerëson se kandidatët me përputhjen më të lartë formale, akademike dhe profesionale kanë përputhje më të drejtpërdrejtë me lëndën “Informatikë dhe programim”, ndërsa për lëndën “Softuerët aplikativë” kërkohet profil më specifik inxhinierik-mekanik dhe njohje e softuerëve të veçantë të përcaktuar në syllabus. Prandaj, Komisioni paraqet vlerësimin dhe propozimin si në vijim:

1. Erzë Ahmeti përmbush qartë kushtet bazë për angazhim në pozitën e ushtrimeve. Ajo ka përputhje shumë të mirë pedagogjike dhe praktike me lëndën “Informatikë dhe programim”, për shkak të përvojës në mësimdhënie, Python, Java/JavaScript, front-end, web/mobile dhe AI. Megjithatë, pas krahasimit me syllabuset, nuk dokumentohet përvojë e drejtpërdrejtë me MathCad në nivelin e kërkuar nga lënda, as me Maple, IQ100 dhe Working Model 2D për lëndën “Softuerët aplikativë”.
2. Erëza Abdullahu është kandidaturë shumë e mirë dhe renditet si rezervë e parë: ka master në fushë përkatëse, nota mbi pragun e kërkuar, master me diplomë të dyfishtë, përvojë kërkimore/trajnuese dhe publikime të lidhura me AI, programim, computer vision, IoT, DBMS dhe sisteme softuerike. Pas krahasimit me syllabuset, Komisioni vlerëson se përputhja e saj më e drejtpërdrejtë është me lëndën “Informatikë dhe programim”. Për lëndën “Softuerët aplikativë”, nuk dokumentohet përvojë specifike me Maple, IQ100 dhe Working Model 2D.
3. Rinor Muçaj ka kualifikim të vlefshëm dhe nota mbi pragun minimal, por përputhja e tyre me pozitën 17 mbetet e kufizuar. Rinor Muçaj ka afërsi të pjesshme me përmbajtjen inxhinierike të lëndës “Softuerët aplikativë”, për shkak të profilit të tij në inxhinieri mekanike/energjetike, por nuk dokumenton njohuri ose përvojë me Maple, IQ100 dhe Working Model 2D.
4. Arben Mujaj ka përvojë në fushën e komunikacionit dhe softuerë përkatës, por jo në informatikë/programim dhe as në softuerët specifikë të syllabusit. Prandaj, asnjëri nuk propozohet për angazhim në pozitën 17.




Komisioni propozon që për pozitën 17 të angazhohet kandidatja Erzë Ahmeti. Kandidatja Erëza Abdullahu renditet e dyta dhe konsiderohet si kandidate rezervë e parë vetëm për lëndën "Informatikë dhe programim".

**Vërejtje:** Në bazë të analizës së syllabuseve, Komisioni vlerëson se kandidatja e propozuar Erzë Ahmeti dhe kandidatja rezervë Erëza Abdullahu mund të angazhohen për ushtrime vetëm në lëndën "Informatikë dhe programim", pasi profili i tyre akademik dhe profesional përputhet më drejtpërdrejt me përmbajtjen e kësaj lënde. Për lëndën "Softuerët aplikativë", nuk rekomandohen për shkak të fokusit të syllabusit në softuerë specifike inxhinierikë.

**Kandidatja Erzë Ahmeti i plotëson plotësisht kushtet rregullative dhe paraqet profilin më të përshtatshëm për natyrën e kësaj pozite:**

- ka të përfunduar masterin "Information Technology with Management" në University of St Andrews, me Distinction,
- ka rezultate akademike mbi prapën e kërkuar në të dy nivelet: GPA 3.95/4.0 (summa cum laude) në bachelor (RIT Kosovo, program 4-vjeçar amerikan, Web/Mobile Computing & Management) dhe rezultat me Distinction në master, të dyja mbi notën 8 sipas konvertimit të arsyeshëm,
- meqenëse pozita është për ushtrime, pra rol thelbësisht pedagogjik dhe praktik, kandidatja ka përparësi të qartë në mësimdhënie dhe punë praktike: përvojë si ligjëruese/mësimdhënëse e informatikës, vlerësim studentor 92%, trajnime praktike në Python dhe front-end development, si dhe përvojë në web/mobile, UI/UX dhe AI, kompetenca drejtpërdrejt të aplikueshme në udhëheqjen e ushtrimeve për lëndët e pozitës 17,
- Po ashtu, në aspektin e renditjes ndërkombëtare të universiteteve, institucioni ku kandidatja Erzë Ahmeti ka kryer studimet e Masterit, University of St Andrews (e renditur në top 162 sipas Times Higher Education (THE) World University Rankings<sup>1</sup> dhe 113 sipas QS Rankings<sup>2</sup>) qëndron ndjeshëm më lart në renditjet botërore se institucionet përkatëse të kandidatëve të tjerë, gjë që e përforcon peshën akademike dhe besueshmërinë e kualifikimeve të saj.

Nënshkrimet e Komisionit Vlerësues

| Roli    | Emri dhe mbiemri            | Nënshkrimi  |
|---------|-----------------------------|---|
| Kryetar | Prof. Dr. Ramë Likaj        |   |
| Anëtar  | Prof. Dr. Ahmet Shala       |  |
| Anëtar  | Prof.Asst. Dr. Ilir Murturi |  |

<sup>1</sup> THE Rankings (<https://www.timeshighereducation.com/world-university-rankings/university-st-andrews>)

<sup>2</sup> QS Rankings (<https://www.topuniversities.com/universities/university-st-andrews>)



# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Nr. Prot: 1021  
Datë: 25/06/2026

## RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (*ad junct*)

|                                      |   |
|--------------------------------------|---|
| <b>Fakulteti:</b>                    | Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike / Departamenti i Mekatronikës   |
| <b>Pozita e shpallur në thirrje:</b> | Pozita 18 - Asistent i angazhuar për ushtrime   |
| <b>Lëndët:</b>                       | Mekanika teknike I (O, BA); Grafika inxhinierike (O, BA); Mekanika teknike II (O, BA).  |
| <b>Kandidatët e paraqitur:</b>       | 1. Arlinda Elezi<br>2. Trëndelina Morina<br>3. Rinor Muçaj<br>4. Verona Gojnovci<br>5. Arben Mujaj  |
| <b>Thirrja për angazhim:</b>         | Sipas thirrjes/vendimit nr. 1/746, datë 29.05.2026  |
| <b>Vendimi për komisionin:</b>       | Komisioni është emëruar me vendim të Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, mbledhja e datës 17.06.2026.                                       |
| <b>Komisioni vlerësues:</b>          | 1. Kryetar - Prof. Dr. Ramë Likaj<br>2. Anëtar - Prof. Dr. Ahmet Shala<br>3. Prof.Asst.Dr. Ilir Murturi   |
| <b>Qëllimi i raportit:</b>           | Shqyrtimi i dokumentacionit të kandidatëve dhe propozimi për angazhim si bashkëpunëtor i jashtëm/asistent i angazhuar për ushtrime për pozitën përkatëse. |

TABELA VLERËSUESE E KANDIDATËVE

| Nr. | Emri dhe mbiemri  | Kualifikimi / grada   | Apl. për ligjërata / thirrja akademike | Publikimet / dëshmi relevante  | Nota BA | Nota MA | Mosha / datëlindja | Përvoja në fushën përkatëse  | Bie ndesh me Rreg. nr. 2/254 (PO/JO) | Renditja | Propozohet (PO/JO) |
|-----|-------------------|---|--|--|---------|---------|--------------------|--|--------------------------------------|----------|--------------------|
| 1.  | Arlinda Elezi     | MSc në Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment, BSc në Inxhinieri Industriale dhe Menaxhment | Jo / nuk aplikohet                     | Dëshmi për pjesëmarrje/prezantim në konferencë ndërkombëtare studentore: "Analysis of Group Technology and surface roughness for cutting processes". | 8.84    | 9.69    | 10.05.1999         | Design Engineer / Mechanical Design Engineer: CAD, SolidWorks, Autodesk Inventor, BoM, modele CAD, vizatime inxhinierike dhe kalkulime inxhinierike.                         | JO                                   | 1        | PO                 |
| 2.  | Trëndelina Morina | MSc në Mekatronikë, BSc në Mekatronikë  | Jo / nuk aplikohet                     | Nuk janë dorëzuar dëshmi të veçanta për publikime shkencore/profesionale.  | 8.75    | 9.88    | 06.01.2003         | Përvojë praktike/profesionale në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, Ferplast dhe Bora Dental SH.P.K.: instalim, servis, mirëmbajtje, diagnostikim dhe verifikim pajisjesh. | JO                                   | 2        | JO                 |
| 3.  | Rinor Muçaj       | MSc në Sistemet e Energjisë së Ripërtëritshme, BSc në Termoenergjetikë dhe Energji të Ripërtëritshme      | Jo / nuk aplikohet                     | Nuk janë dorëzuar dëshmi të veçanta për publikime shkencore/profesionale.  | 8.58    | 9.69    | 30.01.2000         | Inxhinier projektues HVAC, udhëheqës në punishte dhe menaxhim projektesh: AutoCAD/AutoCAD MEP dhe softuerë inxhinierikë.   | JO                                   | 3        | JO                 |
| 4.  | Verona Gojnovci   | MSc në Mekatronikë: BSc në Inxhinieri Industriale dhe Menaxhment  | Jo / nuk aplikohet                     | Punim shkencor/professional: "Regulation of the liquid inflow level through a closed-loop system": Distinguished Paper Award, ICISE 2026.            | 8.45    | 9.06    | 02.03.2000         | Design engineer në Nettxio, Assistant manager në Auto Passion: praktikë/përvojë në ORCA dhe KEK: AutoCAD/SolidWorks/MathCAD.   | JO                                   | 4        | JO                 |
| 5.  | Arben Mujaj       | MSc në Komunikacion Rrugor, BSc në Komunikacion dhe Transport   | Jo / nuk aplikohet                     | Nuk janë dorëzuar dëshmi të veçanta për publikime shkencore/profesionale.  | 8.38    | 9.06    | 19.09.1997         | Ligjërues profesional dhe instruktor në autoshkollë: praktikë në komunë dhe në ekspertiza të aksidenteve/komunikacionit.   | JO                                   | 5        | JO                 |

**VLERËSIMI I NOTAVE NË LËNDËT E POZITËS 18**

Për secilin kandidat u shqyrtuan notat në lëndët për të cilat aplikohet: Mekanika teknike I, Grafika inxhinierike dhe Mekanika teknike II. Kur kandidati nuk ka dorëzuar certifikatë të notave të lexueshme për lëndët përkatëse, kjo është shënuar si mungesë në dokumenta.

| Nr. | Kandidati         | Mekanika teknike I   | Grafika inxhinierike   | Mekanika teknike II  | Mesatarja e lëndëve relevante | Vlerësimi i notave lëndore   |
|-----|-------------------|--|--|--|-------------------------------|--|
| 1.  | Arlinda Elezi     | 7  | 8  | 9  | 8.00                          | Ka dëshmi të plotë për tri lëndët. Nota 7 në Mekanika teknike I është më e ulët, por kompensohet nga nota 9 në Mekanika teknike II, nota 8 në Grafikë inxhinierike dhe përvoja e drejtpërdrejtë në CAD/vizatime inxhinierike.                            |
| 2.  | Trëndelina Morina | 7  | 9  | 9  | 8.33                          | Ka rezultate të mira në lëndët përkatëse, sidomos në Grafikë inxhinierike dhe Mekanika teknike II. Së bashku me notën shumë të lartë MA 9.88 dhe profilin në Mekatronikë, kjo e bën shumë konkurruese për pozitën.                                       |
| 3.  | Rinor Muçaj       | 8  | 10   | 9  | 9.00                          | Ka mesataren më të lartë në tri lëndët e pozitës 18. Kjo është përparësi e qartë akademike, por profili BA/MA dhe përvoja profesionale janë më shumë të orientuara në termoenergjetikë, energji dhe HVAC.  |
| 4.  | Verona Gojnovci   | 7  | 7  | 9  | 7.67                          | Ka nota të dokumentuara në tri lëndët. Nota 9 në Mekanika teknike II është e mirë, ndërsa notat 7 në Mekanika teknike I dhe Grafikë inxhinierike janë më të ulëta krahasuar me kandidatët e renditur më lart. Përvoja në CAD/projektim mbetet përparësi. |
| 5.  | Arben Mujaj       | Nuk është evidentuar certifikatë e notave për lëndët përkatëse | Nuk është evidentuar certifikatë e notave për lëndët përkatëse | Nuk është evidentuar certifikatë e notave për lëndët përkatëse | Nuk vlerësohet numerikisht    | Në dosjen e shqyrtuar janë evidentuar diploma BA/MA dhe CV, por jo certifikata e notave për tri lëndët e pozitës 18. Për këtë arsye nuk mund të bëhet krahasim i drejtpërdrejtë lëndor.  |

## RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlerësues shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur për pozitën 18 - asistent i angazhuar për ushtrime në Departamentin e Mekatronikës. Në këtë pozitë kanë aplikuar pesë kandidatë: Arlinda Elezi, Trëndelina Morina, Rinor Muçaj, Verona Gojnovci dhe Arben Mujaj. Vlerësimi është bërë në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, përputhjes së kualifikimit me lëndët e pozitës, notave mesatare BA/MA, notave në lëndët konkrete të pozitës 18, përvojës profesionale/praktike dhe dëshmime të tjera relevante.




1. Arlinda Elezi ka përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Industriale dhe Menaxhment me notë mesatare 8.84 dhe studimet Master në Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment me notë mesatare 9.69. Në lëndët e pozitës 18 ka këto rezultate: Mekanika teknike I - 7, Grafika inxhinierike - 8 dhe Mekanika teknike II - 9, me mesatare lëndore 8.00. Kandidatja ka përvojë të drejtpërdrejtë si Design Engineer dhe Mechanical Design Engineer, me përdorim të CAD, SolidWorks dhe Autodesk Inventor, përfshirë modele CAD, vizatime inxhinierike, BoM dhe kalkulime inxhinierike. Për këtë arsye, Komisioni vlerëson se ajo ka përputhjen më të mirë të përgjithshme me kërkesat praktike të Grafikës inxhinierike dhe ushtrimeve të mekanikës teknike.
2. Trëndelina Morina ka përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Mekanike - Mekatronikë me notë mesatare 8.75 dhe studimet Master në Mekatronikë me notë mesatare 9.88. Në lëndët e pozitës 18 ka këto rezultate: Mekanika teknike I - 7, Grafika inxhinierike - 9 dhe Mekanika teknike II - 9, me mesatare lëndore 8.33. Këto rezultate, së bashku me profilin në Mekatronikë dhe notën shumë të lartë në nivelin Master, e bëjnë kandidaten shumë të përshtatshme për pozitën. Ajo renditet e dyta, kryesisht për shkak se përvoja e drejtpërdrejtë në projektim/grafikë inxhinierike dhe CAD është më e theksuar te kandidatja e renditur e para.
3. Rinor Muçaj ka përfunduar studimet Bachelor në Termoenergjetikë dhe Energji të Ripërtëritshme me notë mesatare 8.58 dhe studimet Master në Sistemet e Energjisë së Ripërtëritshme me notë mesatare 9.69. Në lëndët e pozitës 18 ka rezultatet më të larta të dokumentuara: Mekanika teknike I - 8, Grafika inxhinierike - 10 dhe Mekanika teknike II - 9, me mesatare lëndore 9.00. Kjo është përparësi e rëndësishme akademike. Megjithatë, profili i tij i specializimit dhe përvoja profesionale janë më shumë në termoenergjetikë, HVAC dhe energji, prandaj në vlerësimin e përgjithshëm renditet i treti.
4. Verona Gojnovci ka përfunduar studimet Bachelor në Inxhinieri Mekanike - Inxhinieri Industriale dhe Menaxhment me notë mesatare 8.45 dhe studimet Master në Mekatronikë me notë mesatare 9.06. Në lëndët e pozitës 18 ka këto rezultate: Mekanika teknike I - 7, Grafika inxhinierike - 7 dhe Mekanika teknike II - 9, me mesatare lëndore 7.67. Kandidatja ka përvojë në projektim/CAD dhe dëshmi për punim shkencor/profesional, por notat lëndore dhe mesataret BA/MA janë më të ulëta krahasuar me kandidatët e renditur më lart. Për këtë arsye renditet e katërta.
5. Arben Mujaj ka përfunduar studimet Bachelor në Komunikacion dhe Transport me notë mesatare 8.38 dhe studimet Master në Komunikacion Rrugor me notë mesatare 9.06. Kandidati ka përvojë si ligjërues profesional dhe instruktor në autoshkollë, si dhe përvojë në komunikacion/ekspertiza të aksidenteve. Në dosjen e shqyrtuar nuk është evidentuar certifikatë e notave për tri lëndët e pozitës 18, prandaj nuk mund të bëhet krahasim i drejtpërdrejtë lëndor. Profili i tij është më i lidhur me komunikacionin rrugor sesa me mekanikën teknike/grafikën inxhinierike, prandaj renditet i pesti.

### Përfundimi

Në përfundim, duke kombinuar kualifikimin, notat mesatare, notat në lëndët konkrete të pozitës, përvojën profesionale dhe përputhjen me nevojat e ushtrimeve, Komisioni vlerësues propozon që për **pozitën 18 të angazhohet kandidatja Arlinda Elezi**. Kandidatët e tjerë vlerësohen si të kualifikuar në aspektin formal, por nuk propozohen për angazhim në këtë pozitë sipas renditjes dhe arsytimit të mësipërm.

Vërejtje teknike: Për kandidatin Arben Mujaj, në dosjen e shqyrtuar nga Komisioni nuk është evidentuar certifikatë e notave për tri lëndët e pozitës 18; prandaj notat lëndore janë shënuar si të padëshmuara dhe nuk janë zëvendësuar me supozime.

NËNSHKRIMET E KOMISIONIT VLERËSUES

| Roli    | Emri dhe mbiemri           | Nënshkrimi  |
|---------|----------------------------|---|
| Kryetar | Prof. Dr. Ramë Likaj       |  |
| Anëtar  | Prof. Dr. Ahmet Shala      |  |
| Anëtar  | Prof.Asst.Dr. Ilir Murturi |  |



Nr. Prot: 1027  
Datë: 26 / 06 / 2026

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (ad junct)**

Fakulteti: Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike  
Pozita e shpallur në thirrje: VI.19  
Lëndët: Fizikë (O, BA).  
Florentina Hamidi-Sadiku  
Flutura Balaj  
Kandidatët e paraqitur: Havushe Ahmeti  
Ilir Jusufi  
Latif Hasi  
Mendrit Latifi  
Thirrja për angazhim: Nr. prot. 1/746, Dt. 29.05.2026

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar Prof. Beqir Hamidi  
2. Anëtar Prof. Nase Lajqi  
3. Anëtar Prof. Asst. Halil Demolli





|    |                |                              |   |   |   |      |      |     |                    |   |    |    |
|----|----------------|------------------------------|---|---|---|------|------|-----|--------------------|---|----|----|
| 3. | Havushe Ahmeti | Msc                          | - | - | - | 8.86 | 8.23 | N/A | 58<br>(15.09.1968) | 3 | JO | JO |
| 4. | Ilir Jusufi    | Msc                          | - | - | - | 8.90 | 9.06 | N/A | 28<br>(03.12.1998) | 0 | JO | JO |
| 5. | Latif Hasi     | Msc                          | - | - | - | 8.27 | 9.11 | N/A | 27<br>(21.04.1999) | 2 | JO | PO |
| 6. | Mendrit Latifi | Msc,<br>PhD<br>Candi<br>tate | - | - | - | 8.55 | 8.00 | N/A | 29<br>(10.08.1997) | 0 | JO | JO |

## RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlerësues, i emëruar nga Këshilli i FIM më 22.06.2026 për shqyrtimin e aplikacioneve për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm (ad junct) për lëndët e shpallura në Pozitën Nr. 19 të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve të paraqitur dhe vlerësimit sipas kriterëve të përcaktuara në Rregulloren nr. 2/254, datë 17.07.2024, konstaton si në vijim:

1. **Florentina Hamidi-Sadiku, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 7.93 dhe studimet master me notë mesatare 7.15. Kandidatja plotëson kushtet formale të thirrjes dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254.
2. **Flutura Balaj, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 8.09 dhe studimet master me notë mesatare 9.90. Kandidatja plotëson kushtet formale të thirrjes dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254.
3. **Havushe Ahmeti, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 8.86 dhe studimet master me notë mesatare 8.23. Kandidatja plotëson kushtet formale të përcaktuara në thirrje dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254.
4. **Ilir Jusufi, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 8.90 dhe studimet master me notë mesatare 9.06. Kandidati plotëson kushtet formale të përcaktuara në thirrje dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254.
5. **Latif Hasi, M.Sc.**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 8.27 dhe studimet master me notë mesatare 9.11. Kandidati plotëson kushtet formale të përcaktuara në thirrje dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254.
6. **Mendrit Latifi, M.Sc., PhD Candidate**, ka përfunduar studimet bachelor me notë mesatare 8.55 dhe studimet master me notë mesatare 7.60. Kandidati plotëson kushtet formale të përcaktuara në thirrje dhe nuk bie ndesh me dispozitat e Rregullores nr. 2/254.

Pas shqyrtimit të përgjithshëm të dokumentacionit dhe vlerësimit të kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara në thirrje dhe në rregulloret në fuqi, Komisioni vlerësues propozon për angazhim si bashkëpunëtor i jashtëm kandidatin **Latif Hasi**. Arsyetimi i propozimit bazohet në përmbushjen e kushteve të kërkuara për pozitën e shpallur dhe notën mesatare të studimeve dhe përvojën e punës, i cili gjatë vitit akademik 2024-2025 dhe 2025-2026 ka qenë i angazhuar si asistent i lëndës së fizikës në FIM.


Prandaj, Komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe organeve kompetente të Universitetit të Prishtinës që kandidati **Latif Hasi** të angazhohet si bashkëpunëtor i jashtëm për lëndët e shpallura në Pozitën Nr. 19.

Prishtinë,  
Më 26.06.2026

Komisioni:

Prof. Beqir Hamidi, Kryetar \_\_\_\_\_ 

Prof. Naser Lajqi, Anëtar \_\_\_\_\_ 

Prof. Asst. Halil Demolli, Anëtar \_\_\_\_\_ 



# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Nr. Prot:

1035

Datë:

26 / 06 / 2026

## RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (ad junct)

I Inxhinierisë Mekanike

Fakulteti:

Pozita 20.

Pozita e shpallur në thirrje:

Kapituj E Biznes dhe E Commerce (O, BA)

Lëndët:

*(shto radhë nëse duhet)*

Kandidatët e paraqitur:

1. Erëz Ahmeti
2. Arlind Tasholli




*(shto radhë nëse duhet)*

Nr. prot. 1/746, Dt. 29.05.2026

Thirrja për angazhim:

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Beqir Hamidi   
Prof. Fatos Ukaj   
Prof. Asoc. Afrim Gjelaç 

|   |                 |     |     |                 |  |   |  |                    |   |   |                                  |
|---|-----------------|-----|-----|-----------------|--|---|--|--------------------|---|---|----------------------------------|
| 2 | Arlind Tasholli | MSc | MSc | Grada shkencore | Thirrja akademike  | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime | Moshë (datëlindja) | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet) | Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP. (PO/JO) | Propozohet të angazhohet (PO/JO) |
|   |                 |     |     |                 |  |   |  |                    |   |   |                                  |
| 1 | Erzë Ahmeti     | MSc | MSc | Grada shkencore | Thirrja akademike  | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime | Moshë (datëlindja) | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet) | Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP. (PO/JO) | Propozohet të angazhohet (PO/JO) |
| 2 | Arlind Tasholli | MSc | MSc | Grada shkencore | Thirrja akademike  | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata | Aplikohet për bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime | Moshë (datëlindja) | Përvoja e punës në fushën përkatëse (vitet) | Bie ndesh me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP. (PO/JO) | Propozohet të angazhohet (PO/JO) |
|   |                 |     |     |                 | Publikimet në revista shkencore ndërkombëtare, në përputhje me Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP |   |  |                    |   |   |                                  |
|   |                 |     |     |                 | Përvoja e punës profesionale në mjekësinë terciare (Fakulteti i Mjekësisë)   |   |  |                    |   |   |                                  |
|   |                 |     |     |                 | Nota Ba.   |   |  |                    |   |   |                                  |
|   |                 |     |     |                 | Nota Ma.   |   |  |                    |   |   |                                  |
|   |                 |     |     |                 | Specializimi për lëndët klinike në Fakultetin e Mjekësisë/ përkatësisht certifikata profesionale për kontabilitet dhe auditim  |   |  |                    |   |   |                                  |
|   |                 |     |     |                 |  |   |  |                    |   |   |                                  |

**RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES**

*(Ky raport duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohet/n për angazhim si bashkëpunëtor/ë i/të jashtëm).*

Kandidati **Arlind Tasholli** është propozuar për pozitën 13.  
Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe vlerësimit të të dhënave të paraqitura në tabelën përkatëse, propozon kandidaten **Erzë Ahmeti** për angazhim.



Nr. Prot: 1036  
Datë: 26 / 06 / 2026

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM (ad junct)**

I Inxhinierisë Mekanike

Fakulteti:

Pozita 21.

Pozita e shpallur në thirrje:

Lëndët:

Kapituj: Ndërmarrësi dhe inovacion dhe Certifikimi i produktit  
(O, BA)  
*(shto radhë nëse duhet)*

Kandidatët e paraqitur:

1. Arlind Tasholli
2. Lendë Gashi

*(shto radhë nëse duhet)*

Nr. prot. 1/746, Dt. 29.05.2026

Thirrja për angazhim:


Komisioni vlerësues:

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Beqir Hamidi

Prof. Fatos Ukaj

Prof. Asoc. Afrim Gjellaj



Handwritten signatures in blue ink corresponding to the names listed to the left. The first signature is for Prof. Beqir Hamidi, the second for Prof. Fatos Ukaj, and the third for Prof. Asoc. Afrim Gjellaj.



## RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

*(Ky raport duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohet/n për angazhim si bashkëpunëtor/ë i/të jashtëm).*

Kandidati **Arlind Tasholli** është propozuar për pozitën 13.  
Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe vlerësimit të të dhënave të paraqitura në tabelën përkatëse, propozon kandidatin **Lendë Gashi** për angazhim.